



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 1995/Prot.

Tiranë, më 3.10.2025

NJOFTIM PUBLIK

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z. ELVIS
KALAJA NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.414 DATË 28.03.2025, TË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS”**

Lagjia nr.4 Rr. “Naum Çausi” shtëpi private, Durrës

Me Vendimin nr.414 datë 28.03.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me palë paditëse znj. Elvira Kalaja, përfituese e ndihmës juridike dytësore (referuar vendimit nr. 34 Prot., datë 10.07.2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës) dhe të paditur z. Elvis Kalaja me objekt *“Zgjidhja e martesës ligjore midis paditëse Elvira Kalaja dhe të paditurit Elvis Kalaja, pa përcaktua fajësinë, Lëniene në përgjegjësi prindërore për rritje dhe edukim të fëmijëve Emili Kalaja, e datëlindjes 03.07.2010 dhe Khloe Kalaja e datëlindjes 24.08.2014 paditëses Elvira Kalaja, dhënien e autorizimit paditëses Elvira Kalaja për t’u zhvendosur jashtë shtetit me fëmijët e mitur Emili Kalaja dhe Khloe Kalaja pa qenë i nevojshëm autorizimi i prindit tjetër Elvis Kalaja për arsye edukimi, shëndetësore, argëtimi, pushimi e çlodhjeje, caktimin e detyrimit ushqimor për t’u paguar nga i padituri Elvis Kalaja në masën 15 000 lekë në mua për secilën prej tyre, caktimin e të drejtës të takimit të fëmijëve të mitur me babain e tyre, një herë në muaj”* ku gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve ndërgjyqëse në masën 50% secili.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimin e ofruara ekspertin Natali Lala me vlerë 40 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proçedurës Civile, ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në zbatim të Vendimit nr. 414 datë 28.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shumës prej 20 000 lekë, të paguara nga ana jonë për shpërblim eksperti ofruar për përfituesen e ndihmës juridike dytësore falas znj. Elvira Kalaja.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Procedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 414 datë 28.03.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shumës prej 40 000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim ekspertit, ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore Falas znj Elvira Kalaja.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Elvis Kalaja. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Durrës, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë. Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Durrës depoziton në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)**

Patricia Pogaçe

